

Siguri

Alarmuese: Rugët plot armë – një tjetër pistoletë sekuestrohet gjatë kontrollit policor në Skenderaj



Sinjali.com

07 Gusht 2026 10:36



Fenomeni i armëmbajtjes vazhdon të mbetet shqetësues në Kosovë. Një tjetër armë zjarri është sekuestruar nga Policia gjatë një kontrolli rutinë në Skenderaj, ndërsa pronari i saj ka përfunduar nën hetim.

Sinjali mëson se i dyshuari është **Shkodran Dobra**, .

Burimet bëjnë të ditur se njësia e Reagimit të Shpejtë e Policisë së Kosovës në Mitrovicën e Jugut, gjatë patrullimit në rrugën “Kamer Loshi” në Skenderaj, ka ndaluar një automjet me targa vendore për kontroll.

Gjatë verifikimit, drejtuesi i automjetit ka deklaruar se posedonte armë zjarri dhe ka paraqitur edhe kartelën e lejes për armë të shkurtër, të lëshuar nga Republika e Kosovës.

Megjithatë, pas procedurave policore dhe konsultimit me Prokurorin e Shtetit, arma është sekuestruar, ndërsa ndaj tij është iniciuar rasti “Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”.

I dyshuari është intervistuar në prani të avokatit mbrojtës dhe më pas është liruar në procedurë të rregullt, ndërsa hetimet për sqarimin e plotë të rrethanave të rastit janë duke vazhduar.

Rasti vjen në një kohë kur Policia po raporton pothuajse çdo ditë për sekuestime armësh në qytete të ndryshme të vendit, duke rikthyer shqetësimet për numrin e madh të armëve që qarkullojnë në duart e qytetarëve.

Shënim: Personat e apostrofuat në këtë artikull prezumohen të pafajshëm derisa fajësia e tyre të mos provohet me vendim të formës së prerë nga gjykata.

Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!

/GazetaSinjali/

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



Lajme

Zgjedhjet 2026
Kosovë
Shqipëri
Rajon
Diasporë
Evropë
Botë

Aktualitet

Politikë
Drejtësi
Siguri
Shëndetësi
Arsim
Sociale

Hulumtime

Ekskluzive
Profile
Skandaloze

Ekonomi

Prodhime Vendore
Financa
Biznes

Sport

Botërori 2026
Futboll
Basketboll
Sporte Luftarake
Sporte të tjera

Showbiz

Bota e Yjeve
Modë & Stil
Bukuri dhe kujdes
Të tjera

OP-ED

Analizë
Kolumne
Intervistë

Jetë

Fitness
Ushqime
Travel
Këshilla
Receta
Dieta
Shëndeti

Kulturë

Film
Muzikë
TV & Radio
Libra
Art & Dizajn
Fotografi
Histori

Tech & Auto

Teknologji
Automjete
Telefona
Internet
Lojëra
Aplikacione

Fun

Qesharake
Kuriozitete
Kuize
Fakte
Të tjera